

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT PRIZREN, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Vladimir Kanev, si Kryetar i trupit gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Klaus Huener dhe Gjyqtari kosovar Kujtim Pasuli, si anëtarë të trupit gjykues, në lëndën civile lidhur me kërkesë-padinë për vërtetimin e pronësisë së paditësit Haki Berisha nga Suhareka, i përfaqësuar nga avokati i autorizuar Besim Kuçi nga Suhareka, kundër të paditurve: Ali Rexhaj dhe Sinan Palushi nga fshati Shirokë – Suharekë, të përfaqësuar nga avokati i autorizuar Durak Fondaj, duke vendosur në lidhje me ankesën e përfaqësuesit të të paditurve, të ushtruar më 08.02.2010 kundër Aktgjykimit të gjykatës komunale në Suharekë, C. nr. 181/2006, datë 14.01.2010, në seancën e trupit gjykues të mbajtur më 05.11.2010, shqiptoi këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e përfaqësuesit të të paditurit ushtruar më 08.02.2010 në emër të të paditurit **hidhet poshtë** si e pabazuar.

Aktgjykimi i gjykatës komunale të Suharekës C. nr. 181/2006, datë 14.01.2010 **konfirmohet**, duke cituar,

I. “Kërkesë-padia e Haki Berishës nga Suhareka për verifikimin e pronësisë mbi paluajtshmërinë që u mor në mënyrë të paligjshme nga të paditurit Ali Rexhaj dhe Sinan Palushi nga fshati Shirokë – Suharekë, e përbërë nga ngastra kadastrale nr. 779/4, në vendin e quajtur “Shirokë”, e regjistruar në listën poseduese nr. 275 C.Z. Sopijë, që kufizohet me ngastrën kadastrale nr. 780. dhe për t’i detyruar të paditurit të lirojnë dhe dorëzojnë pasurinë/tokën e kontestuar, **PRANOHET** si e bazuar”.

1. Sinan Palushi nga Shiroka, Komuna e Suharekës, detyrohet t’ia kthejë dhe lirojë pjesën e paluajtshmërisë, paditësit Haki R. Berisha nga Suhareka, ngastra kadastrale 779/4 në vendin e quajtur “Shirokë”, që është e regjistruar në listën poseduese nr. 257 CZ Sopijë dhe me sipërfaqe 44 m², e kufizuar me ngastrën kadastrale 780, me këto përmasa: gjerësia nga kreu deri tek rruga është 1.2m, në drejtim të jugut me gjatësi 40.1m dhe në fund me gjerësi 1m, ose ta kompensojnë në emër të paluajtshmërisë me sipërfaqe 44m² në shumën 3.080 Euro.

2. Ali Rexha nga Shiroka, Komuna e Suharekës, detyrohet t’ia kthejë dhe lirojë pjesën e paluajtshmërisë paditësit Haki R. Berisha nga Suhareka, ngastra kadastrale 779/4 në vendin e quajtur “Shirokë”, që është e regjistruar në listën poseduese nr. 257 CZ Sopijë dhe me sipërfaqe 39 m², e kufizuar me ngastrën kadastrale 780, me këto përmasa: gjerësia në krye nga rruga është 1m, në drejtim të jugut me gjatësi 38.9m dhe në fund me gjerësi 1m, ose ta kompensojë në emër të paluajtshmërisë me sipërfaqe 39m² në shumën 2.780 Euro.

II. Kundërpadia e kundër-paditësve. HIDHET POSHTË në tërësi si e pabazuar dhe me të cilën ata kërkuan të:

“Vërtetohet se kundër-paditësit Sinan Palushi dhe Ali Rexha nga Shiroka Komuna e Suharekës janë pronarë të pjesëve të ngastrës kadastrale 779/4 në vendin e



quajtur "Shirokë", CZ Sopijë, domethënë, Sinan Palushi me sipërfaqen 44 m² dhe Ali Rexhaj me sipërfaqen 39 m², pjesë të cilat janë përdorur nga kundër-paditësit për më shumë se 24 vjet.

Të paditurit janë të detyruar t'i paguajnë bashkërisht paditësit shpenzimet e procedurës në shumën 1.789€.

A r s y e t i m

Pranueshmëria dhe arsyet e Vendimit të ankimuar, C. nr. 181/2006, të GJK Suharekë.

Përfaqësuesi i të paditurve, si pala e pakënaqur, ushtroi ankesë brenda afatit kohor më datë 08.02.2010 kundër Aktgjykimit C. no. 181/2006 të gjykatës komunale të Suharekës, datë 14.01.2010, për:

- Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës civile, Neni 181, paragrafi 1, pika a) lidhur me nenin 182, paragrafi 2 pika n) dhe nenin 199 të LPK-ës;
- Vërtetim të gabuar dhe të paplotë të gjendjes faktike, nga Neni 181, paragrafi 1 pika b) lidhur me Nenin 183 të LPK-ës;
- Zbatim të gabuar të ligjit material, sipas Nenit 18, paragrafi 1, pika c) lidhur me Nenin 184 të LPK-ës;

Me propozimin që gjykata e shkallës së dytë të shqiptojë Aktgjykim – DUKE NDRYSHUAR –Aktgjykimin e ankimuar në mënyrë të tillë që padia e ushtuar nga paditësi Haki Berisha të hidhet poshtë si e pabazuar, ndërsa kërkesa e bërë në kundërpadinë e ushtuar nga kundër-paditësit Sinan Palushi dhe Ali Rexhaj, të dy nga Shiroka, Komuna e Suharekës, të pranohet si e bazuar.


Trupi gjykues i gjykatës së qarkut vlerësoi se ankesa është ushtuar brenda afatit dhe se ankuesit kanë interes ligjor në ankesë.

Sfondi procedural

Më 03.05.2001, paditësi ushtroi kërkesë-padi në GJK Suharekë për verifikimin e pronësisë mbi paluajtshmërinë që u zaptua në mënyrë të paligjshme nga të paditurit Ali Rexhaj dhe Sinan Palushi nga fshati Shirokë – Suharekë, të përbërë nga ngastrat kadastrale nr. 779/4, në vendin e quajtur "Shirokë", regjistruar në listën poseduese nr. 275, C.Z. Sopijë, që kufizohet me ngastrën kadastrale nr. 780. dhe për t'i detyruar të paditurit të lirojnë dhe të dorëzojnë pasurinë / tokën e kontestuar.

Sipas kërkesë-padisë, paditësi deklaroi se është pronari i ligjshëm i ngastrës së kontestuar, e regjistruar në listën poseduese nr. 257, KM Sopijë/Suharekë, si ngastra kadastrale 779/4, me sipërfaqe 44m² dhe 37m², ndër të cilat një pjesë prej 44 metrash katrore u zaptua nga të paditurit në mënyrë të paligjshme.

Ish-pronari, Dervish Rexhep Gashi, ia shiti tokën / ngastrën e tij, që kufizohet me ngastrën e paditësit, të paditurit të dytë, të tretë dhe të katërt. Të paditurit, gjatë ndërtimit të mureve të tyre, zaptuan një pjesë të tokës së paditësit. Paditësi kontaktoi në mënyrë të përsëritur me të paditurit për ta rimarrë tokën në posedim, ose që ata të paguanin kompensim, por ata nuk u janë përgjigjur kërkesave. Si provë ai paraqiti në Gjykatë listën poseduese të planimetrisë së ngastrës së kontestuar. Të paditurit i mohuan pretendimet se kanë zaptuar tokën të paditësit dhe deklaruan se ata janë pronarë të ligjshëm të tokës së kontestuar, bazuar në kontratën e shitblerjes, të lidhur me ish pronarin Dervish Gashi.



Më 24.12.2001, gjykata komunale e Suharekës, në Aktgjykimin e saj të parë të ndërmjetëm, C. nr. 92/2001, vërtetoi pronësinë e paditësit në pasurinë e kontestuar, dhe i obligoi të paditurit të dorëzojnë pasurinë/tokën e kontestuar. Më 19.12.2004, brenda procedurës ankimore, GJQ Prizren në aktvendimin e saj Ac nr. 40/2002, lidhur me ankesën e paditësit, e anuloi Aktgjykimin e ankimuar dhe ia ktheu lëndën GJK për rishqyrtim.

Më 30.06.2003, të paditurit Sinan Palushi dhe Ali Rexhaj ushtruan kundër-padi kundër paditësit Haki Berisha, me pretendimin se ata janë pronarë të ligjshëm të pasurisë së kontestuar bazuar në parashkrimin pozitiv prej më shumë se 24 vjet Ac nr. 40/2002 vjetësh posedimi.

Më 18.10.2004, GJK e Suharekës, në Aktgjykimin e saj C. nr. 254/2002, miratoi kërkesë-padinë dhe konfirmoi pronësinë e paditësit mbi pasurinë e kontestuar, i obligoi të paditurit Sinan Palushi dhe Ali Rexhaj të dorëzojnë pasurinë e zaptuar dhe e hodhi poshtë në tërësi kundër-padinë e të paditurve si të pabazuar.

GJQ Prizren, me Aktvendimin e saj Ac 421/2004, të shqiptuar më 05.06.2006, "E ANULOI" Aktgjykimin e ankimuar dhe ia ktheu lëndën GJK për rishqyrtim.

Më 14.01.2010, GJK e Suharekës, në Aktgjykimin e saj C. nr. 181/06, e obligoi të paditurin Sinan Palushi të dorëzojë pasurinë e zaptuar të paditësit në sipërfaqen totale prej 44m², ose të paguajë kompensim për tokën e zaptuar në shumën 3.080 Euro, dhe të paditurin Ali Rexhaj të dorëzojë pasurinë e zaptuar të paditësit në sipërfaqe totale prej 39m², ose të paguajë kompensim për tokën e zaptuar në shumën 2.780 Euro. Po kështu, me këtë Aktgjykim, gjykata e hodhi poshtë në tërësi kundër-padinë e të paditurit "për të fituar pronësisë mbi sendin nëpërmjet parashkrimit fitues për një periudhë mbi 24 vjeçare" si të pabazuar.

Të paditurit ushtruan ankesë më 08/02/2010 në GJQ Prizren kundër Aktgjykimit të gjykatës komunale të Suharekës, C. nr. 181/06, datë 14.01.2010. Lidhur me këtë ankesë, paditësit nuk paraqitën përgjigje në ankesë.

Vlerësimi ligjor


Ankesa në shqyrtim përqendrohet në kundër-padinë që është hedhur poshtë. Ankuesit pretendojnë se e kishin fituar pronësisë nëpërmjet parashkrimit fitues për 24 vite. Ankesa deklaron se shkalla e parë i vlerësoi gabimisht faktet lidhur me parashkrimin fitues të skrupullt dhe të ligjshëm.

Shkalla e dytë verifikoi sipas detyrës zyrtare procedurën në shkallë të parë dhe nuk gjeti shkelje të dispozitave esenciale të procedurës. Po kështu, shkalla e dytë është e kënaqur që gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar me saktësi faktet në këtë çështje dhe e ka zbatuar me saktësi ligjin material.

Ankuesit nuk arritën ta provojnë parashkrimin fitues të pretenduar të tokës së kontestuar.

Gjatë procedurës në GJK dëshmuan 14 dëshmitarë. Të gjithë, përveç dy dëshmitarëve, dhanë dëshmi lidhur me kohën kur ankuesit ndërtuan shtëpitë e tyre. Duke pasur parasysh se shtëpitë nuk janë ndërtuar në tokën e kontestuar, këto dëshmi nuk kanë lidhje me lëndën. Është e pakontestueshme se tani toka e kontestuar është e rrethuar me gardh nga ankuesit dhe ata e përdorin atë si pjesë të tokës së tyre. Prandaj, çështja në diskutim që duhej provuar ishte se kur u vërdosën këto gjerdhe, duke ia aneksuar kështu këtë pjesë posedimeve të Z. Palushi dhe Z. Rexhaj përkatësisht.

Vetëm dy dëshmitarët bënë fjalë për rrethimin me gardh. Dëshmitari **Mexhit Krasniqi** në dëshminë e tij të datës 20.09.2004, para gjykatës komunale të Suharekës deklaroi se më 19 shkurt 1998 me kërkesë të paditësit ai vizitoi



ngastrën e kontestuar. Në atë kohë ajo ishte e rrethuar me gardh tashmë. Megjithatë, duke e llogaritur nga viti 1998, periudha nuk është e mjaftueshme për të fituar parashkrimin pozitiv.

Dëshmitari **Besim Hoti** në dëshminë e tij të datës 06.10.2004 para gjykatës komunale të Suharekës deklaroi:

“Më kujtohet shumë mirë se në vitin 1977, kur isha vetëm 13 vjec, po udhëtoja me babanë tim në Sopi, dhe rrugës në kthim takova Shefki Gashin në tokën e Sinanit, përkatësisht babai i tij, kur ata po pinin kafe dhe në atë kohë ata jetonin në atë shtëpi, dhe atëherë po ndërtonin një mur.”

Kjo dëshmi nuk është plotësisht e mjaftueshme për përfundim pozitiv në lidhje me kohën kur u përcaktua parashkrimi fitues. Për më tepër, edhe dëshmia e Z. Hoti është e besueshme, ajo nuk bën fjalë për atë pjesë të gardhit që qëndron ndërmjet ngastrave të paditësit dhe ankuesve.

Për arsyet e cekura më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv konform Nenit 195.1 (d) të LPK-së.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
AC. nr. 88/2010 datë 05.11.2010

Mjet juridik: Kundër këtij aktgjykimi nuk lejohet ankesë.

Kryetar i trupit gjykues

Vladimir Kanev

